

Iniciativa qytetare e femrave ANTIKO

KORNIZA INSTITUCIONALE DHE JURIDIKE PËR BARAZINË GJINORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË



KORNIZA INSTITUCIONALE DHE JURIDIKE PËR BARAZINË GJINORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Botues: Iniciativa qytetare e femrave ANTIKO

Redaktore: Danica Jovanova

Përkthyes dhe lektor: Besnik Emini

Dizajni grafik: Studio për dizajn grafik "KARMA DS"

Shkup, Dhjetor 2011

HYRJE

Hyrja në konceptin gjinor në rrjedhat shoqërore është e mundur vetëm nëse autorët kyçë në bashkësi bashkë me qytetarët e tjerë, e zhvillojnë dhe e kultivojnë vetëdijen për respektim të barazisë gjinore dhe nëse praktikisht angazhohen për zbatimin e saj, si në nivel nacional, ashtu edhe në nivel lokal. Inkorporimi i prioritetëve dhe interesave të ndryshme në politikat nacionale dhe lokale, zbatimimi i përpiktë i rregullave ligjore dhe funksionimi i pandërprerë i mekanizmave për mundësi të barabarta janë parakushtet themelore për sigurimin e barazisë mes grave dhe burrave dhe pranimi i të njëjtës si vlerë themelore e shoqërisë bashkëkohore demokratike.

Iniciativa Qytetare e Femrave ANTIKO në kuadër të programit të saj vjetor, e përkrahur nga Programi Civica Mobilitas, i cili implementohet nga ana e Qendrës për Zhvillim Institucional – CIRa dhe i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), jep kontribut ndaj tejkalimit të vlerave patriarkale dhe krijim të kushteve për të drejtat e njëjta, mundësi dhe përgjegjësi për të gjithë qytetarët. Kjo nënkupton përpjekje aktive për ndërtim të kapaciteteve të strukturave kompetente dhe rritje të vetëdijes gjinore të qytetarëve; përfshirje të perspektivës gjinore në politikat dhe programet e institucioneve qeveritare, njësi të vetëqeverisjes lokale, partive politike dhe aktorëve të tjerë kyçë në bashkësi; si edhe implementimi praktik i politikave të cilat kanë të bëjnë me mundësitë e barabarta në të gjitha segmentet e jetës shoqërore.

Gjatë vitit 2011 ANTIKO vendosi bashkëpunim me Universitetet në Republikën e Maqedonisë, duke e pasur parasysh se popullata studentore dhe profesorët e tyre mund të japin kontribut dhe në mënyrë aktive të inkuadrohen në proceset për përmirësim të legjislacionit ekzistues për barazi gjinore, përshtatjen e tij me standardet e BE-së dhe zhvillim të veglave përkatëse për zbatim efektiv në praktikë.

Kjo broshurë paraqet vegël praktike në të cilën janë përmbledhur aktet themelore juridike, politikat dhe mekanizmat për barazi gjinore, dhe ka për qëllim t'i informojë dhe t'ua lehtësojë punën të gjitha subjekteve dhe palëve të prekura në përpjekjet për funksionim të pandërprerë të makinerisë gjinore në Republikën e Maqedonisë dhe implementimin e kornizës juridike, dokumenteve dhe politikës strategjike.

Iniciativa Qytetare e Femrave ANTIKO

Vështrim i kornizës kyçe juridike për barazinë gjinore në Republikën e Maqedonisë

Në periudhën e kaluar vendi ynë miratoi dhe/ose ndryshoi një numër të konsiderueshëm të ligjeve të cilat kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut dhe mundësitë e barabarta, si edhe të institucioneve dhe mekanizmave për mbrojtjen e tyre. Zbatimi i kësaj legjislaturore në praktikë realizoi ndikim ndaj vetëdijes së qytetarëve dhe ndaj perceptimit të institucioneve qeveritare në lidhje me parimet demokratike dhe barazinë gjinore dhe kjo paraqet bazë të mirë për sigurimin e sistemit të pavarur dhe të qëndrueshëm për mbrojtjen dhe implementimin e tyre. Në vazhdim është dhënë pasqyrë e akteve relevante ligjore të cilët kanë të bëjnë me mundësitë e barabarta të grave dhe burrave.

KUSHTETUTA e Republikës së Maqedonisë (1991) përmban më shumë norma në raport me liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit. Në pjesën e të drejtave qytetare dhe politike është përcaktuar se *“Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja nacionale dhe sociale, bindja politike dhe fetare, pozita pronësore dhe shoqërore”*. Me normat e caktuara përcaktohet parimi i barazisë dhe garantohen të drejtat e barabarta pavarësisht nga gjinia.

Me përfshirjen e barazisë mes gjinive në normat e Kushtetutës është shprehur vullneti politik i organit më të lartë ligjvënës, se Republika e Maqedonisë gjendet mes atyre shteteve demokratike të cilat rendin e tyre e ndërtojnë me pranim dhe promovim të plotë të mundësive të barabarta mes grave dhe burrave, si parakusht që nuk mund të lihet anash për zhvillim të qëndrueshëm demokratik.

LIGJI PËR MUNDËSI TË BARABARTA TË GRAVE DHE BURRAVE (i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në maj të vitit 2006, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 66/2006)

Ligji për mundësi të barabarta, i miratuar në maj të vitit 2006, i rregullon masat themelore dhe të posaçme për vendosje të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, si edhe kompetencat, detyrat dhe obligimet e subjekteve përgjegjëse për vendosjen e mundësive të barabarta, procedurën për përcaktim të trajtimit të pabarabartë të grave dhe burrave, si edhe të drejtat dhe obligimet e Përfaqësuesit për mundësitë e barabarta të grave dhe burrave. **Qëllimi i këtij ligji është vendosja e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në fushën politike, ekonomike, sociale, arsimore kulturore, shëndetësore, qytetare dhe cilëndo qoftë fushë të jetës shoqërore.**

Definicion i shprehjes “mundësi të barabarta” del nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave (CEDAW) dhe është identik me definicionet që i përmbajnë ligjet në vendet tjera.

Me qëllim të krijimit të mundësive më të mira për mbrojtje të personave të cilët veten e llogarisin si viktimë të ndonjë forme të diskriminimit, ky ligj krijon supozime për mbrojtje të atillë të asaj mënyre që përshkruan procedurë për përcaktim të trajtimit të pabarabartë të burrave dhe grave dhe përcakton Përfaqësues për mundësi të barabarta të grave dhe burrave.

Ky person llogaritet i punësuar si nëpunës publik në kompetencë të sektorit kompetent në Ministrinë e punës dhe politikës sociale, e cila do të jetë e angazhuar ta udhëheqë procedurën për përcaktim të trajtimit të pabarabartë të grave dhe burrave.

Në vitin 2008 janë bërë ndryshime dhe plotësime të Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave me qëllim që të përshtaten definicionet për diskriminim të përmbajtura në Ligj me direktivën 2002/73/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian.

Ministria e punës dhe politikës sociale dhe Sektori për mundësi të barabarta **në maj të vitit 2011 filluan me procesin e përgatitjes së ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave.**

Pas analizave dhe konsultimeve të bëra u detektua se ndryshimet do të tejkalonin 1/3 e normave të ligjit ekzistues, që e imponoi nevojën për përgatitje të ligjit të ri. **Propozim teksti i Ligjit të ri për mundësi të barabarta të grave dhe burrave është përpunuar dhe gjendet në procedurë parlamentare.** Ligji është kthesë në procesin për barazi gjinore në Republikën e Maqedonisë për shkak se ky është ligji i parë i posaçëm për barazi gjinore i cili parasheh pako masash për promovim të mundësive të barabarta të burrave dhe grave dhe i jep kompetenca të posaçme Ministrisë së punës dhe politikës sociale si përkrahje të rolit të tij të rregulluesit të çështjeve gjinore.

LIGJI PËR PARANDALIM DHE MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI (2010)

Me këtë ligj sigurohet pengimi dhe mbrojtja nga diskriminimi në realizimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ligjet dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, me ç'rast mbrojtja dhe ndalimi nga diskriminimi ka të bëjë me të gjithë personat fizikë dhe juridikë në procesin e realizimit të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutën dhe me ligjet e Republikës së Maqedonisë.

LIGJ PËR GJYQET (2006)

Ligji e garanton të drejtën e qasjes së barabartë deri te të gjitha gjyqet në Republikën e Maqedonisë për shkak të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të njeriut në bazë të normave pozitive ligjore. Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve nuk duhet të ketë diskriminim në raport me gjininë, racën, ngjyrën e lëkurës, statusin shoqëror dhe/ose karakteristikave tjera, ndërsa gjykatësit gjatë kryerjes së funksionit gjyqësor nuk guxojnë t'i diskriminojnë palët gjatë procedurës në asnjë bazë.

KODI PENAL (1996)

Kodi penal e inkriminon diskriminimin në cilëndo qoftë bazë nga ana e cilitdo personi në Maqedoni dhe krijon obligim për personat e autorizuar të veprojnë me kujdes të obligueshëm dhe pa diskriminim në kryerjen e detyrës ligjore.

Ndryshime dhe plotësime të Kodit penal (2004)

Me ndryshimet dhe plotësimet e Kodit penal, përcaktohet dhuna familjare. Nën shprehjen dhunë familjare nënkuptohet keqtrajtimi, lëndimi i ashpër, cenimi i sigurisë, lëndimi trupor, dhuna gjinore ose dhuna tjetër psikike ose fizike, me të cilën shkaktohet ndjenjë e pasigurisë, kërcënim ose frikë, ndaj partnerit të kurorëzuar, prindërve dhe fëmijëve, ose personave të tjerë të cilët jetojnë në bashkësi martesore ose jashtëmartesore ose amvisëri të përbashkët, si edhe ndaj partnerit të mëparshëm të kurorëzuar ose persona të cilët kanë fëmijë të përbashkët ose persona që gjenden në raporte të afërta personale.

Me veprat penale kundër jetës dhe trupit, janë sanksionuar privimi nga jeta, dëmtimi ose rrënimi i integritetit trupor, ose shkaktimi i dhembjes fizike ose shpirtërore (lëndim trupor ose lëndim i rëndë trupor), respektivisht formë fizike e dhunës. Nëpërmjet veprave penale dhunë, privim kundërligjor nga liria dhe cenimi i sigurisë, janë sanksionuar format e dhunës psikike, ndërsa dhuna seksuale sanksionohet nëpërmjet veprave penale dhunim, çnderim ndaj personit të pafuqishëm, sulm fizik ndaj fëmijës ose ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit.

LIGJI PËR PARTITË POLITIKE (2004)

Ky ligj përshkruan se programi dhe statuti i partive politike nuk mund të jenë të drejtuara ndaj shkaktarëve të urrejtjes ose padurimit nacional, fetar dhe racor. Ndalohej çdo lloj diskriminimi i mbështetur në anëtarësim ose mosanëtarësim në partinë politike, ndërsa garantohet barazia e gjinive nga aspekti i qasjes së funksioneve në PP.

KODI ZGJEDHOR (2006)

Ligji garanton përfaqësim përkatës dhe të drejtë të burrave dhe grave në organet zgjedhore dhe e imponon parimin sipas të cilit mes tre pozitave në listën e kandidatëve për deputetë dhe anëtarë të këshillave të komunave, së paku një vend i takon gjinisë së përfaqësuar më pakë.

LIGJI PËR ZGJEDHJE TË DEPUTETËVE (2004)

Me këtë ligj përcaktohet se në listën e propozuar të kandidatëve secila gjini do të jetë e përfaqësuar me së paku 30%.

LIGJI PËR ZGJEDHJE LOKALE (2004)

Në këtë ligj është përcaktuar se në listën e propozuar të kandidatëve për anëtarë të këshillit të komunës dhe Qytetit të Shkupit secila gjini do të jetë e përfaqësuar me së paku 30% edhe në gjysmën e sipërme edhe në gjysmën e poshtme të listës.

LIGJI PËR VETËQEVERISJEN LOKALE (2002)

Ligji e rregullon themelimin dhe punën e Komisioneve për mundësi të barabarta në kuadër të këshillave të komunave, respektivisht normat e Ligjit parashikojnë obligim që Këshillat të themelojnë komisione të tilla.

LIGJI PËR FAMILJEN (1992)

Ligji garanton pozitë të barabartë të partnerëve të kurorëzuar (bura dhe gra) në raport të të drejtave të tyre dhe obligimeve ndaj njëri tjetrit dhe ndaj fëmijëve të tyre.

Ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familje (2004)

Me ndryshimet dhe plotësimet në këtë ligj, përcaktohet se Republika siguron mbrojtje të kurorës dhe familjes nga raportet e rrënuara dhe dhuna në bashkësi martesore dhe familje. Ndalohet çdo lloj dhune në kurorë dhe familje.

Në Ligjin për familje **dhunë familjare** llogarite sjellja e anëtarit të familjes i cili me përdorimin e forcës, kërcënimit edhe për familjen, frikësimit, kryen lëndime trupore, keqpërdorim emocional ose seksual dhe shfrytëzim material, seksual dhe ose punues të anëtarit tjetër të familjes. Vend qendror në Ligjin për familjen në raport me mbrojtjen nga dhuna familjare, u takon **Masave të përkohshme për mbrojtje** të viktimave të dhunës familjare, të cilat kanë për qëllim mbrojtje të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë të viktimës. Në rastet e lëndimit serioz ose serisë së incidenteve të shoqëruara me intensitet të shtuar, masat e përkohshme për mbrojtje dhe ndjekje penale bashkërisht, mund të arrijnë rezultate më efikase.

LIGJI PËR MBROJTJEN SOCIALE (2009)

Ligji ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë ose indirekt në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë nacionale, sociale, politike, fetare, pronësore dhe shoqërore, në raport me realizimin e të drejtave nga fusha e mbrojtjes sociale. Kjo ndalesë vlen baras edhe për institucionet publike për mbrojtjen sociale të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, komunat, qyteti i Shkupit, institucionet private për mbrojtje sociale të themeluara nga personat juridikë ose fizikë të cilat kryejnë punë nga fusha e mbrojtjes sociale.

LIGJI PËR MARRËDHËNIET E PUNËS (2005)

Ligji përmban norma për trajtim të barabartë të burrave dhe grave në raport me qasjen deri te punësimi, trajnimi profesional dhe avancimi, si edhe në kuptim të kushteve të punës. Ligji përmban norma të posaçme mbrojtëse për të punësuarit nga gjinia femërore në kuptim të shtatzënësisë, punës së natës dhe llojeve të tjera të punës, si edhe norma për mbrojtje nga mobingu.

LIGJI PËR TRASHËGIMI (1996)

Të drejtat për trashëgimi janë të garantuara me Kushtetutën dhe me Ligjin për Trashëgimi të Republikës së Maqedonisë. Ligji nuk njihet asnjë lloj dallimi mes trashëgimtarëve, respektivisht të gjithë njerëzit kanë të drejtë ta realizojnë të drejtën e tyre të trashëgimisë në vendin tonë.

LIGJI PËR ARSIM TË MESËM (1995)

LIGJI PËR ARSIM TË LARTË (2008)

Garantohet qasje e barabartë deri te institucionet arsimore (arsimimi i mesëm dhe i lartë) dhe ndalohet diskriminimi në cilëndo qoftë bazë.

LIGJI PËR PUNË TË BRENDSHME (1995)

Qëllimi kryesor i ligjit është mbrojtja e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe të sigurojë mungesë të urrejtjes dhe padurimit nacional, racor dhe fetar.

Dokumente të tjera kyçe, politika dhe strategji të tjera për barazi gjinore

Plani nacional për aksion për barazi gjinore (PNABGJ), si dokument strategjik i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për periudhën e viteve **2007-2012**, **i përcakton dhjetë fushat strategjike për veprim, aktivitetet, indikatorët, si edhe institucionet përgjegjëse, faktorët dhe palët e përfshira për vendosjen e barazisë gjinore në fushat e ndryshme.** PNABGJ-ja ka për qëllim ta përmirësojë statusin e grave dhe të sigurojë zhvillim të vazhdueshëm të barazisë gjinore. Implementimi i PNABGJ-së me sukses zhvillohet nëpërmjet përgatitjes së planeve vjetore operative për implementim.

Plani nacional për aksion për barazi gjinore është dokumenti i dytë nacional i këtij lloji, qëllimi themelor i së cilës është të përmirësohet statusi i grave dhe të sigurohet zhvillimi i vazhdueshëm në realizimin e barazisë gjinore. Ky dokument paraqet përgjigje nacionale ndaj obligimeve ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë dhe përpjekje që të bashkohen të gjitha qëndrimet, aktivitetet dhe burimet në kornizën koherente dhe qasje e vetme për arritje të barazisë gjinore. Baza e PNABGJ-së janë Platforma e Pekingut dhe Plani i Aksionit, CEDAW, qëllimet zhvillimore të mijëvjeçarit, obligimet të cilat dalin nga procesi i integrimit evropian dhe përshtatjen dhe afrimin e Republikës së Maqedonisë pranë Bashkimit Evropian, si edhe obligimet tjera ndërkombëtare.

Strategjia nacionale për mbrojtje nga dhuna familjare (2008-2011) paraqet dokument themelor strategjik të Republikës së Maqedonisë, i cili ka për qëllim përcaktimin e drejtimeve strategjike dhe prioriteteve për parandalimin e këtij lloji të dhunës, dhe përcaktimin e

bartësve përgjegjës për zbatimin e tyre.

Qëllimi kryesor strategjik i Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna familjare është zvogëlimi i paraqitjes së dhunës familjare dhe përmirësimi i cilësisë së mbrojtjes me masa sistemore në fushat/domenet e parandalimit, intervenimit, edukimit, ndjekjes dhe koordinimit ndërmjet sektorëve, për shkak të veprimit efektiv dhe efikas për ballafaqim me dhunën familjare me sigurimin e qëndrimit dhe qasjes së vetme. Organizatat qytetare janë faktorë dhe partnerë kyçë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për promovim dhe avancim të të gjitha formave të mbrojtjes nga dhuna familjare.

Dhuna në familje, përfshinë edhe përdorimin e forcës, kërcënimit dhe frikësimit, si edhe keqpërdorim emocional dhe seksual. Në Republikën e Maqedonisë, me këtë strategji do të vazhdohet rruga e gjertanishme e institucioneve të sistemit, ndërsa ky është ballafaqim rrënjësor me problemet e dhunës familjare, rrënimin e të gjitha pengesave të lidhura me të njëjtën, si edhe vështirimi se në këtë nuk duhet të shikohet si “punë private familjare”, por si problem shoqëror, që nënkupton nevojë për përfshirje të të gjithë faktorëve relevantë.

Strategjia nacionale për punësim (2015) është dokument në të cilin janë përfshirë strategjitë afatmesme për punësim. Kjo në vete i përfshinë sfidat kryesore të tregut të punës për periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2015 nga aspekti i politikave makroekonomike dhe mikroekonomike, politikat për punësim dhe politika e tregut të punës, pastaj politikat nga fusha e sigurimit social dhe mbrojtjes sociale, si edhe përcaktimi i qëllimeve dhe politikave konkrete për punësim të cilat do të mundësojnë realizim të qëllimeve të përfshira në strategjinë për punësim. Për herë të parë, perspektiva gjinore është e përfshirë në një dokument strategjik nga fusha e punës.

Strategjia nacionale për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrimit ilegal (2009-2012)
– Qëllimi i kësaj Strategjie më të re, gjithëpërfshirëse për luftë kundër tregtisë me njerëz është të iniciojë kuptim të përbashkët për detyrat kyçe dhe vlerat thelbësore të të drejtave të njeriut në luftën kundër tregtisë me njerëz në Republikën e Maqedonisë. Misioni i saj është të përcaktojë prioritete strategjike për luftë kundër tregtisë me njerëz, të përcaktojë detyre specifike për institucionet përgjegjëse, si edhe t'i përshtatë aktivitetet ndër-institucionale për arritje të qëllimeve të përcaktuara, si në nivel lokal ashtu edhe regjional. Misioni është, gjithashtu, të sigurohet përmirësim i cilësisë së shërbimeve të cilat u janë siguruar viktimave, dhe të intensifikohet hetimi, ndjekja penale dhe dënimi i kryerësve.

Si plotësim i këtij dokumenti të përgjithshëm, është përgatitur edhe Plan aksioni për luftë kundër tregtisë me fëmijë.

Strategjia për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrimi ilegal 2009-2012 është përgatitur sipas përvojave dhe leksioneve të mësuara nga të gjitha institucionet nacionale, organizatat ndërkombëtare joqeveritare, përgjegjëse për implementimin e Strategjisë nacionale dhe Planit të Aksionit për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrimit ilegal për vitet 2006-2008.

Subjekte përgjegjëse për miratimin dhe zbatimin e masave për vendosjen e masave të barabarta të grave dhe burrave dhe obligimet e tyre

Deri në vitin 2007, me çështjen e barazisë gjinore merrej Ministria e punës dhe politikës sociale, më saktësisht Seksioni për avancim dhe barazi me gjinive në Sektorin për punë. Pas sjelljes së Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave në vitin 2006, në këtë ministri është formuar Sektori për mundësi të barabarta. Në kreun 4 të Ligjit për mundësi të barabarta, janë përcaktuar obligimet e të gjitha institucioneve përgjegjëse për miratimin dhe kryerjen e masave për implementimin e mundësive të barabarta.

Në këtë moment, mekanizmin institucional/makinerinë gjinore që kujdeset për zbatimin e politikave e përbëjnë:

- **Spektori i mundësive të barabarta në kuadër të Ministrisë për punë dhe politikë sociale (MPPS)**

Spektori për mundësi të barabarta është formuar në mars të vitit 2007, me Aktin e sistematizimit dhe organizimit të Ministrisë për punë dhe politikë sociale.

Rrethi i punës së Ministrisë së punës dhe politikës sociale në raport me mundësitë e barabarta të grave dhe burrave është përcaktuar në nenin 14 të Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave.

Në pajtim me Nenin 16 të Rregullores për organizim të brendshëm të Ministrisë së punës dhe politikës sociale nr. 04-1644/1, të 30.07.2010, Sektori përbëhet nga dy njësi – **Njësia për barazi gjinore dhe Njësia për parandalim dhe mbrojtje nga çdo lloj i diskriminimit.**

Në kuadër të Sektorit është emëruar **Përfaqësues juridik** për udhëheqje të procedurës për përcaktim të trajtimit të pabarabartë të grave dhe burrave. Ai është përgjegjës për ofrim të ndihmës juridike falas dhe është kompetent për udhëheqje të procedurës për përcaktim të pabarabartë. Përfaqësuesi i mundësive të barabarta të grave dhe burrave në kuadër të kompetencave të veta, i pavarur kryen punë dhe detyra që kanë të bëjnë me mbrojtjen juridike të personave të diskriminuar në bazë të gjinisë dhe ngritjes së procedurës për përcaktim të trajtimit të pabarabartë të grave dhe burrave në pajtim me normat e Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, bashkëpunon me subjektet kompetente (organi kompetent i inspeksionit, avokati i popullit ose organi tjetër kompetent), përgatit raporte vjetore dhe analiza dhe kryen punë të tjera.

Kompetenca të Sektorit për mundësi të barabarta:

-ndjekja dhe koordinimi i procesit të implementimit të Ligjit për mundësi të barabarta (LMB) dhe Plani nacional për aksion për barazi gjinore (PNABGJ) dhe përgatitja e raporteve vjetore;

-përkrahja e ministrive të resorit dhe organet tjera qeveritare në nivel nacional dhe lokal në

implementimin e PNABGJ-së dhe LMB-së;

-përgatitja e planeve vjetore për realizim të qëllimeve të përcaktuara në PNABGJ me përkujdesje të parimit të transparencës dhe participimit;

-inicimi dhe formimi i grupeve ndërministrore dhe ndërsektoriale për ndjekje të implementimit të PNABGJ-së;

-informimi i rregullt i komiteteve për eliminim të të gjitha llojeve të diskriminimit të gruas pranë KB-së.

■ **Koordinatorët për mundësi të barabarta të grave dhe burrave në Ministrinë**

Koordinatorët emërohen në pajtim me nenin 14, paragrafët 3, 4 dhe 5 të Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, të cilët përcaktojnë se ministrinë janë të obliguara të përcaktojnë person zyrtar – koordinues, i cili është përgjegjës për zbatimin e obligimeve në kompetencë të ministrisë për vendosjen e mundësive të barabarta, është i obligueshëm një herë në vit të dorëzojë raport për punën deri te Ministria e punës dhe politikës sociale.

Kompetenca:

-koordinimi i punëve në kompetencë të ministrisë së resorit, për vendosjen e mundësive të barabarta;

-mbledhja e të dhënave statistikore për gjendjen me barazinë gjinore në ministrinë dhe dorëzimin e të dhënave deri te Sektori për mundësi të barabarta pranë MPPS-së;

-marrja e masave dhe aktiviteteve në drejtim të zhvillimit të parimeve për vendosje të mundësive të barabarta të grave dhe burrave dhe vendosjes së kushteve për pjesëmarrje të balancuar të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe vendosjen e tyre në të gjitha detyrat, si edhe mënjanimi i pengesave për zhvillim të këtyre parimeve;

-ndjekja e direktivave të BE-së nga fusha e mundësive të barabarta dhe dhënia e nismave për implementimin e tyre në legjislaturën vendase;

-implementimi i PNABGJ-së dhe LMB-së.

■ **Komisioni për mundësi të barabarta të grave dhe burrave në njësitë e vetëqeverisjes lokale**

Me fillimin e procesit të decentralizimit në Republikën e Maqedonisë, në njësitë e vetëqeverisjes lokale janë formuar Komisionet për mundësi të barabarta të grave dhe burrave me qëllim që të inkorporohet perspektiva gjinore dhe mundësitë e barabarta në politikën lokale, ta avancojnë gjendjen e grave në nivelin lokal dhe t'i realizojnë qëllimet strategjike të Planit nacional për aksion për barazi gjinore dhe të Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave.

Detyra kryesore e komisioneve është të punojnë për avancimin e gjendjes së grave dhe të sigurojnë mundësi të barabarta për burrat dhe gratë në nivel lokal nëpërmjet procesit të përgatitjes dhe miratimit të politikave, zbatimit të tyre, monitorimit dhe evoluimit të rezultateve të arritura.

Njëkohësisht, organet dhe degët e njësive të vetëqeverisjes lokale gjatë miratimit të planeve zhvillimore dhe akteve dhe vendimeve të tjera, janë të obligueshëm të shqyrtojnë dhe t'i marrin parasysh masat dhe aktivitetet e propozuara nga ana e Komisionit për mundësi të barabarta dhe koordinatorit për mundësi të barabarta.

Komisioni për mundësi të barabarta është i obligueshëm që së paku një herë në vit për punën e vet të dorëzojë raport deri te Ministria e punës dhe politikës sociale (neni 17). Deri tani, komisione të këtilla janë formuar në 80 nga gjithsejtë 84 komuna në Republikën e Maqedonisë.

■ **Koordinatorët për mundësi të barabarta të grave dhe burrave në njësitë e vetëqeverisjes lokale**

Koordinatori për mundësi të barabarta të grave dhe burrave është person i administratës komunale me status të nëpunësit shtetëror i cili krahas obligimeve të tjera në kuadër të punës së tij, merret me avancimin e barazisë mes burrave dhe grave dhe i jep përkrahje Komisionit në realizimin e kompetencave dhe obligimeve të tij. Kryetari i komunës e emëron koordinatorin. Koordinatorë për mundësi të barabarta të grave dhe burrave janë emëruar në 80 nga gjithsejtë 84 komuna.

■ **Komisioni për mundësi të barabarta të grave dhe burrave në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë**

Komisioni për mundësi të barabarta të grave dhe burrave është formuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2006, ndërsa detyra kryesore e tij është ta ndjekë inkuadrimit dhe aspekteve të barazisë gjinore në normat ligjore. Komisioni për mundësi të barabarta të grave dhe burrave ka kryetar, dhjetë anëtarë dhe zëvendës të tyre.

Komisioni, mes kompetencave të tjera i shqyrton edhe propozimet e ligjeve dhe rregullave të tjera që i miraton Kuvendi nga fusha e punës dhe politikës sociale, arsimit dhe shëndetësisë, familjes dhe kujdesit për fëmijët, si edhe propozimeve të tjera të ligjeve dhe rregullave të tjera nga aspekti i inkuadrimit të konceptit gjinor në to; e shqyrton propozimin e Planit nacional për aksion për mundësi të barabarta të grave dhe burrave dhe iniciacionin e ndryshimit të ligjeve dhe rregullave të tjera nga fusha e mundësive të barabarta të grave dhe burrave.

■ **Avokati i popullit**

Avokati i popullit kujdeset në kuadër të kompetencës së vet të përcaktuar me ligj për realizimin e parimit të mundësive të barabarta nëpërmjet mbrojtjes juridike të mundësive të barabarta të grave dhe burrave kur të drejtat e dikujt janë marrë ose janë kufizuar nga organi

i drejtorisë shtetërore ose nga organizatat me autorizime publike.

■ **Faktorët tjerë përgjegjës për miratimin dhe kryerjen e masave për vendosje të mundësive të barabarta:**

- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë
- Partitë politike
- Mjetet për informim publik
- Organizatat joqeveritare

Dokumente ndërkombëtare për barazi gjinore

Pozita juridike dhe statusi i grave në Republikën e Maqedonisë, krahas Kushtetutës, janë rregulluar edhe me marrëveshjet ndërkombëtare të cilat Republika e Maqedonisë i ka nënshkruar, ratifikuar dhe/ose ndaj të cilave është bashkëngjitur, e të cilat në pajtim me nenin 118 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë janë pjesë përbërëse e rendit tonë juridik. Njëri ndër dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare i cili paraqet kornizë themelore juridike në fushën e mundësive të barabarta të grave dhe burrave është **Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave (CEDAW)** e cila është miratuar në Kuvendin e Përgjithshëm të OKB-së më 18 dhjetor 1979, ndërsa ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1981.

Si shtet trashëgues i ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Republika e Maqedonisë iu bashkëngjiti Konventës për eliminim të të gjitha formave të diskriminimit kundër gruas në vitin 1994, e cila hyri në fuqi më 17 shtator 1991 kur shteti e morri përgjegjësinë e detyrueshme para bashkësisë ndërkombëtare. Republika e Maqedonisë e ka nënshkruar edhe Protokollin fakultativ ndaj kësaj Konvente në vitin 2000, i cili është ratifikuar më 24 qershor të vitit 2003, ndërsa ka hyrë në fuqi më 17 tetor të vitit 2003.

Me ratifikimin e Protokollit, Republika e Maqedonisë e ka pranuar kompetencën e Komitetit për eliminim të të gjitha formave të diskriminimit të gruas dhe në atë mënyrë u mundëson qytetarëve të drejtohen deri te komiteti në rast të cenimit të cilësdo qoftë të drejte të caktuar me Konventën.

Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar edhe **Konventën evropiane për mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të Këshillit të Evropës (ECHR-1950) dhe Protokollit nr. 12 ndaj Konventës Evropiane për mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.** Kjo konventë në normat e saja themelore thotë se realizimi i të drejtave dhe lirive të caktuara në Konventë do të realizohen pa diskriminim në kuptim të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes nacionale dhe sociale, besimit politik dhe fetar, gjendjes materiale dhe shoqërore. Protokollin mundëson ndalim të përgjithshëm të diskriminimit dhe e forcon dhe e zgjeron normën ekzistuese të mosdiskriminimit, të përfshirë në Nenin 14 të Konventës Evropiane për mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale. Republika e Maqedonisë e ratifikoi Protokollin nr. 12 më 13 qershor 2004.

Deklarata e Pekingut dhe Platforma për aksion si edhe përfundimet e mara nga Sesioni special i Këshillit të Përgjithshëm të KB-së në vitin 2000 (Peking+5 dhe Peking+10) janë posaçërisht të rëndësishëm për proceset e përfshirjes së koncepteve gjinore në rrjedhat shoqërore në shtetin tonë.

Republika e Maqedonisë është e obliguar të punojë në plotësimin e **Qëllimeve zhvillimore të mijëvjeçarit të Kombeve të bashkuara**, respektivisht të sigurojë plotësim të politikave vendore me obligimet ndërkombëtare.

Norma të tjera ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me mundësitë e barabarta të grave dhe burrave:

■ **Rekomandimet e Komitetit të ministrave deri te vendet anëtare të Këshillit të Evropës:**

- Rekomandimi Nr. P (85)2 për mbrojtjen ligjore kundër diskriminimit seksual;
- Rekomandimi Nr. P (96)5 përshtatje të punës dhe jetës familjare;
- Rekomandimi Nr. P (98)12 për përfshirje të barazisë mes gjinive në rrjedhat kryesore shoqërore.

■ **Rekomandimet e miratuara nga Kuvendi parlamentar i Këshillit të Evropës:**

- Rekomandimi 1229 (1994) për barazinë e të drejtave mes burrave dhe grave;
- Rekomandimi 1269 (1995) për arritjen e përparimit real për të drejtat e grave i vitit 1995;
- Rekomandimi 1413 (1999) për përfaqësimin e barabartë në jetën politike.

■ **Rekomandime të tjera:**

- Rekomandimi 96/649/EC për pjesëmarrje të balancuar të burrave dhe grave në procesin e vendosjes;
- Rekomandimi 84/635/EEC për promovim të zbatimit të masave për aksione pozitive të grave;
- Rekomandimi 92/131/EEC për mbrojtje të dinjitetit të burrave dhe grave në punë;
- Rekomandimi 87/567/EEC për përsosje profesionale të grave.

■ **Rezolutat:**

- Rezoluta (95/C 296/06) e 05.10.1995 për shfaqjen dhe paraqitjen e burrave dhe grave në reklamat dhe mediet;
- Rezoluta (85/C 166/1) e vitit 1985 e cila përmban Program aksioni për zbatim të parimit të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në arsim.

■ **Deklaratat:**

- Deklarata e 19.12.1991 për implementimin e rekomandimit të Komisionit për mbrojtje të dinjitetit të grave dhe burrave në punë, duke i përfshirë edhe rregulltat për veprim për pengim të shqetësimit gjinor;

■ Direktivat e bartura në legjislaturën vendore

- 75/117/EEZ – Direktivë e lidhur me bartjen e parimit të rrogës së barabartë për burrat dhe gratë;
- 76/207/EZ – Direktiva për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion;
- 2000/78/EZ – Direktiva për vendosje të kornizës së përgjithshme për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion;
- 97/80/EZ – Direktiva për ngarkesën e dëshmimit në rast të diskriminimit në bazë të gjinisë;
- 92/85/EEZ – Direktiva për mbrojtje të grave shtatzëna
- 2004/113/EZ – Direktiva për implementim të parimit të trajtimit të barabartë të grave dhe burrave në qasjen dhe sigurimin dhe mallrave dhe shërbimeve
- 2000/43/EZ – Direktiva për zbatim të parimit të trajtimit të barabartë të njerëzve pa dallim të racës së tyre ose prejardhjes etnike
- 2002/72/EZ – Direktivë me të cilën ndryshohet dhe plotësohet Direktiva
- 76/2007/EEZ – Direktiva e Këshillit për zbatim të parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave që ka të bëjë me qasjen deri te punësimi, përgatitja profesionale dhe avancimi e deri te kushtet e punës

TERMINOLOGJIA GJINORE

Gjinia – Gjinia u referohet roleve sociale, sjelljeve, vlerave dhe aktiviteteve dhetributeve të mara vesh të cilat një shoqëri e caktuar i llogarit si të përshtatshme për gratë dhe burrat. Gjinia është identitet i fituar i cili është mësuar, ndryshohet gjatë kohës dhe ndryshon gjerësisht në dhe gjatë kulturave.

Poli – shprehja pol udhëzon në karakteristikat biologjike dhe fiziologjike të cilat i përcaktojnë burrat dhe gratë. Poli biologjik është përcaktuar nga karakteristikat gjenetike dhe anatomike.

Rolet gjinore – Rolet gjinore janë sjellje të mësuara në shoqërinë ose bashkësinë e dhënë ose grupin tjetër të posaçëm, respektivisht aktivitete, detyra dhe përgjegjësi të cilat janë perceptuar si mashkullore dhe femërore. Rolet gjinore janë të përcaktuara nga mosha, klasa, raca, etniteti, religjioni si edhe nga mjedisi gjeografik, ekonomik dhe politik. Ndryshimet në rolet e gjinive shpesh shfaqen si përgjigje ndaj ndryshimit të rrethanave ekonomike, natyrore ose politike, duke i përfshirë edhe përpjekjet zhvillimore.

Diskriminim – domethënë secili dallim, shfrytëzim ose kufizim ndaj njerëzve në bazë të identiteteve kolektive (poli/gjinia, klasa, etnia, identiteti seksual) me çka kërcënohet ose mundësohet realizimi ose mbrojtja e të drejtave dhe lirive njerëzore.

Diskriminimi i poleve – direkt – Diskriminimi direkt i poleve do të thotë krijimi i trajtimit të pabarabartë nëpërmjet rregullave ose veprimeve ndaj individëve ose grupeve varësisht nga gjinia, në situata të njëjta ose të ngjashme në realizimin, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Diskriminimi i poleve – indirekt – Diskriminimi indirekt i poleve do të thotë trajtimi i pabarabartë i personave të gjinisë së ndryshme i pranishëm në rregullat, standardet ose sjelljet e ndryshme të cilat formalisht shkaktojnë mundësi të barabarta ose në shikim të parë janë neutrale, por zbatohen në mënyrë të ndryshme varësisht nga poli, ose nëse kjo është në interes dhe është e nevojshme për sigurimin e mbrojtjes së posaçme ose është shkaktuar nga kushtet objektive që nuk janë të lidhura me gjininë. Kjo ka të bëjë me praktikën kur pavarësisht nga trajtimi formal i barabartë i ligjeve krijon dallim në rezultatet ose në rezultatin e veprimit të rregullave të tilla të “barabarta”, ndërsa kjo nuk mund t’u shkruhet aftësive personale të personave për të cilët bëhet fjalë.

Buxhetet e ndjeshme gjinore – kanë të bëjnë me një sërë procedurash dhe mjetes, të cilat mundohen ta vlerësojnë ndikimin e buxheteve të pushteteve ndaj grupeve të ndryshme të burrave dhe grave, duke i theksuar mënyrat me të cilat relacionet gjinore i mbështetin shoqëria dhe ekonomia. Buxhetet gjinore nuk janë buxhete të posaçme për gra. Ata përfshijnë analiza të shpërndarjes së përcaktuar gjinore të mjeteve sipas kategorisë gjini, i klasifikojnë ndikimet e të dalave themelore nëpër të gjitha sektorët dhe shërbimet dhe i rishqyrtojnë politikat dhe shpërndarjen e mjeteve në shërbimet qeveritare sipas kriterëve të mundësive të barabarta të grave dhe burrave. Mund të përfshijnë ridestininim të mjeteve për programe të veçanta qëllimi i të cilave janë gratë.

Analiza gjinore – Ka të bëjë me metodat e shumta të cilat përdoren që të kuptohen relacionet mes burrave dhe grave, qasjen e tyre ndaj burimeve, aktivitetet e tyre dhe kufizimet me të cilat ata ballafaqohen kur lidhen mes veti. Analiza gjinore siguron informata për njohjen se gjinia dhe lidhjet e saja me racën, etnitetin, klasën, moshën, invaliditetin dhe/ose statusin tjetër është e rëndësishme në kuptimin e formave të ndryshme të angazhimit, sjelljen dhe aktivitetet të cilat burrat dhe gratë i kanë në strukturat ekonomike, sociale dhe juridike.

Analiza gjinore është pjesë e procesit të krijimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave në sferën publike të cilat janë relevante për qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e bashkësisë. Për këtë qëllim, analiza gjinore duhet t’i analizojë procedurat e ndryshme në krijimin e politikave me qëllim që të sigurojë dije dhe të propozojë riorganizimin e tyre i cili do të rezultojë me integrimin e perspektivës gjinore.

Informata gjinore analitike – është informatë kualitative për dallimet dhe pabarazitë gjinore. Analiza gjinore shërben që të kuptohet kultura, d.m.th. modelet dhe normat e sjelljes të cilat burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat i praktikojnë dhe i provojnë në raport me çështjen e cila provohet. Përderisa modelet e dallimeve gjinore dhe pabarazisë zbulohen në të dhënat e klasifikuara sipas gjinisë, analiza gjinore është proces i hulumtimit për shkak se dallimet ekzistojnë, a janë brengosëse dhe si ata mund të vendosen si mjet i analizës dhe aktivizmit të ndjeshëm gjinor.

Barazia gjinore – Barazia gjinore ka të bëjë me konceptin se gratë dhe burrat janë të lirë t’i zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të zgjedhin pa kufizime nga stereotipat e vendosur, paragjykimet dhe rolet e rrepta gjinore. Barazia gjinore do të thotë se sjelljet, aspiratat,

nevojat e ndryshme të grave dhe burrave respektohen, merren parasysh, vlerësohen dhe ndihmohen në mënyrë të barabartë. Kjo do të thotë se të drejtat e tyre, përgjegjësitë dhe mundësitë nuk do të varen nga ajo nëse ata janë të lindura si mashkullorë ose si femërore.

Në kontekst të të drejtave ndërkombëtare të njeriut, koncepti juridik i barazisë gjinore është përfshirë në Deklaratën universale të të drejtave të njeriut të vitit 1948, njëjtë si në Konventën e Kombeve të bashkuara për eliminim të të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave të vitit 1979. Konventa të cilën e ratifikuan 100 vende, e cila qartë dhe pa mëdyshje deklaroi se “diskriminimi ndaj grave i cenon parimet e barazisë së të drejtave dhe respektit ndaj dinjitetit njerëzor”. Qeveritë në botë e vërtetojnë obligimin e tyre të “të drejtave të barabarta dhe dinjitetin immanent njerëzor të të gjitha grave dhe burrave” në Deklaratën e Pekingut dhe Platformën për aksion të vitit 1995.

Barazia gjinore – do të thotë barazi gjatë veprimit me burrat dhe me gratë, në pajtueshmëri me nevojat e tyre të posaçme. Ky koncept ndoshta përmban trajtim të diferencuar, por ai llogaritet si i drejtë nga aspekti i të drejtave, përfitimeve, obligimeve dhe mundësive. Në kontekst të zhvillimit, qëllimi i barazisë gjinore më së shpeshti kërkon masa të posaçme që të kompensohet pengesa historike dhe sociale e grave. Barazia gjinore është e cenuar me avancimin e barazisë personale, sociale, kulturore, politike dhe ekonomike për të gjithë.

Vetëdija gjinore – është kuptimi se ekzistojnë dallime të përcaktuara sociale mes burrave dhe grave të cilat janë mbështetur në sjellje shkencore dhe ndikojnë në aftësinë e tyre për qasje dhe kontroll të burimeve. Kjo vetëdije duhet të zbatohet nëpërmjet analizës gjinore në projekte, programe dhe politika.

Ndjeshmëria gjinore – e përfshinë aftësinë që të kuptohet dhe zbardhet ekzistimi i dallimeve, problemeve dhe pabarazisë gjinore dhe të njëjtat të inkorporohen në strategjitë dhe aksionet për tejkalimin e tyre.

Politikat gjinore (institucionale) – Politikat gjinore janë ndarë në tre kategori varësisht nga vëllimi sipas të cilit ata i njohin dhe vendosin temat gjinore.

1. Politikat e vetëdijshme gjinore: Politikat e vetëdijshme gjinore pranojnë se gratë, njëjtë si edhe burrat, janë pjesëmarrës në zhvillim. Nevojat, interesimet dhe prioritetet e tyre mund të dallohen dhe kohë pas kohe të jenë në kundërthënie. Politikat e vetëdijshme gjinore mund më tej të ndahen në dy lloje të politikave:

- a) Politikat neutrale gjinore – nuk i rrënojnë relacionet ekzistuese gjinore.
- b) Politikat specifike gjinore – Ata e përdorin diturinë për dallimet gjinore në situatën e dhënë që t'u përgjigjen nevojave praktike gjinore qoftë grave qoftë burrave. Këto politika na udhëzojnë në ndarjet aktuale të burimeve dhe përgjegjësie.

2. Politikat e verbëta gjinore: Politikat e tilla nuk kanë sukses të bëjnë dallim mes burrave dhe grave. Politikat janë të njëanshme në dobi të relacioneve ekzistuese gjinore dhe për shkak të kësaj me siguri i ç'krycin gratë.

3. Politikat gjinore redistributive: Ata kanë për qëllim ta transformojnë distribuimin ekzistues të burimeve dhe përgjegjësi me qëllim që të krijojnë raporte të barabarta mes burrave dhe grave. Qëllimi i intervenimit mund të jenë burrat dhe gratë, ose, nga ana tjetër,

vetëm njëri grup. Politikat gjinore redistributive fokusohen kryesisht në interesat strategjike gjinore, por mund t'i kenë në plan edhe nevojat praktike gjinore në mënyrë e cila ka potencial transformues (mundëson mjedis të volitshëm për vetforcim të grave).

Linqe të dobishme

1. Ministria e punës dhe politikës sociale e Republikës së Maqedonisë

<http://www.mtsp.gov.mk/>

<http://www.mtsp.gov.mk/?ItemID=463B79E2DAE454468BBCDFEC8D2D7845>

<http://rodovarnoprapnost.gov.mk/index.php/mk/useful-links>

2. Deklarata universale e të drejtave të njeriut

http://www.dadalos.org/mzd/Menschenrechte/grundkurs_mr2/Materialien/dokument1.htm

3. Konventa për eliminim të të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

<http://untreaty.un.org/cod/avl/ha/cedaw/cedaw.html>

4. Konventa për të drejtat e fëmijëve

<http://www2.ohchr.org/english/law/crc.htm>

5. Deklarata për të drejtën e zhvillimit

<http://www1.umn.edu/humanrts/instree/s3drd.htm>

6. Deklarata e Pekingut dhe Platforma për aksion si edhe Përfundimet e mara vesh nga Sesioni special i Këshillit të përgjithshëm të KB-së në vitin 2000

<http://www.un.org/esa/gopher-data/conf/fwcw/off/a--20.en>

<http://www.un.org/geninfo/bp/women2.html>

7. Rekomandimi 96/694/EC për pjesëmarrje të balancuar të burrave dhe grave në procesin e vendosjes

http://europa.eu/legislation_summaries/employment_and_social_policy/equality_between_men_and_women/c10920_en.htm

<http://www.eulaw.egov.bg/DocumentDisplay.aspx?ID=197029>

8. Rekomandimi 92/131/EEC për mbrojtjen e burrave dhe grave në punë

http://eurlex.europa.eu/smartapi/cgi/sga_doc?smartapi!celexapi!prod!CELEXnumdoc&lg=EN&numdoc=31992H0131&model=guichett

9. Komisioni nacional për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe tregtisë ilegale


<http://www.nacionalnakomisija.gov.mk/>

10. Marrëveshja e Bashkësisë evropiane

http://europa.eu.int/comm/employment_social/gender_equality/index_en.html

Bibliografia:

1. Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave (i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në maj të vitit 2006, ndërsa i shpallur në Gazetën zyrtare të RM-së nr. 66/2006);
2. Plan i nacional për aksion për barazinë gjinore 2007-2012 (i sjellë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në qershor të vitit 2007);
3. Strategjia nacionale për punësim 2011 – 2015;
4. Strategjia nacionale për mbrojtje nga dhuna familjare 2008-2011;
5. Strategjia nacionale për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrimit ilegal 2009-2012;
6. Ministria e punës dhe politikës sociale e Republikës së Maqedonisë - <http://www.mtsp.gov.mk/>;
7. Përkrahja e komisioneve për mundësi të barabarta të grave dhe burrave në njësitë e vetëqeverisjes lokale (botues Ministria e punës dhe politikës sociale, Sektori për mundësi të barabarta, Shkup 2009);
8. Web faqja: <http://rodovaramnopravnost.gov.mk/>



Iniciativa qytetare e femrave ANTIKO
Rr. Tale Hristov lamela 1 lok. 9,
1000 Shkup, Maqedoni, P.O. BOX 1090/1010
Telefon: +389 (0)2 2 61 46 41; (0)2 2 61 11 30
Faks: +389 (0)2 2 60 11 12
e-mail: antiko@t-home.mk, contact@antiko.org.mk
www.antiko.org.mk